



Prishtinë: 24.09.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1040_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1845_08_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.09.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 24.09.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit R. H. nga Prishtina me shifër të konsumatorit: DMI – 12593 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1845_08_18** i datës 15.08.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 06.09.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se organi i shkallës së parë gjatë shqyrtimit të ankesës nuk ka marrë për bazë faktet dhe dëshmitë e paraqitura. Konsumatori ka theksuar se shuma prej 639.36€ me të cilën është ngarkuar është imagjinare edhe përkundër nenit 11.2 të Kodit të Matjes, sepse në ata muaj që nuk ka funksionuar njehsori fajtor nuk ka qenë konsumatori por punëtorët e KEDS-it, ngase është dashur të marrin masa që të lajmërojnë organet kompetente për evitimin e defektit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se organi i shkallës së parë gjatë shqyrtimit të ankesës nuk ka marrë për bazë faktet dhe dëshmitë e paraqitura, Bordi i ZRRE thekson se kjo nuk qëndron ngase gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës, respektivisht procesverbaleve të inspektimit dhe të ndërrimit të njehsorit elektrik ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEDS-it gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0096674 të datës 18.04.2016 kanë konstatuar se gjatë kontrollimit të njehsorit elektrik nr.16080430 është vërejtur kthimi mbrapa i kWh të shpenzuar,



andaj edhe duhet të dërgohet në laboratorin e kalibrimit për shqyrtim. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar edhe procesverbalin e qendrës së kalibrimit nr. org. 02 nr. 8686 i datës 06.06.2016 dhe ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik ka vulat (bllombat) shtetërore, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, si dhe kanë konstatuar se gabimi në matje në tarifën e lartë është **-32.26%**. Po ashtu në procesverbal është evidentuar vërejtja sipas së cilës njehsorit elektrik i është paraqitur FF.000A000, bateria e harxhuar, si dhe që kohë pas kohe njehsori e ka resetuar energjinë elektrike.

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe ka vërejtur spas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik-kontestues nr.16080430 konstaton se konsumatori nga periudha korrik 2015, përveç periudhës dhjetor 2015, deri në periudhën prill 2016 kur edhe është bërë ndërrimi i njehsorit nuk ka fare regjistrim të shpenzimit të energjisë elektrike. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive vërehet se me njehsorin elektrik nr.16080430 prej periudhës 01/2012 deri në periudhën 12/2012 mesatarja mujore e shpenzimit është **949 kWh/muaj**, prej periudhës 01/2013 deri në periudhën 12/2013 mesatarja mujore e shpenzimit është **938 kWh/muaj**, si dhe prej periudhës **01/2014** deri në periudhën 12/2014 mesatarja mujore e shpenzimit është **943 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.64646325 për periudhën 01/2017 deri në periudhën 12/2017 mesatarja mujore e shpenzimit është **1,015 kWh/muaj**. Andaj vërehet qartë se bazuar në mesataren e shpenzimeve me dy njehsorët elektrik konstatohet se konsumatori nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike, ndërsa nga periudha korrik 2015, përveç periudhës dhjetor 2015, deri në periudhën prill 2016 nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike të regjistruar e të faturuar.

Sai përket pikës së kundërshtimit të KEDS-it se vlera e ngarkuar nga KESCO është imagjinare edhe përkundër nenit 4.11.2 të Kodit të Matjes, Bordi i ZRRE thekson se ka shqyrtuar korrigjimin nr. 29933DMI-12593 në vlerë 639.36€ të bërë nga KESCO dhe konstaton se KESCO me korrigjimin e bërë ka vepruar konform nenit 4.11.2 të Kodit të Matjes, ku thuhet se: *"Në rastin kur konstatohet se njehsori ka gabuar 100, nuk ka regjistruar fare, atëherë korrigjimi i energjisë elektrike do të bëhet sipas mesatares paraprake të shpenzimit të konsumatorit, gjithashtu te rastet e defektit të ndonjë sistemi matës (pa ndonjë ndërhyrje të qëllimshme) veprohet me mesatare duke zbritur shpenzimin e regjistruar dhe faturuar"*. Andaj Bordi i ZRRE thekson se vlera e ngarkuar nga KESCO nuk është imagjinare por është sipas dispozitave të nenit 4.11.2 të Kodit të Matjes.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit R. H.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.